Po kështu, ndërkohë që distributorët i furnizojmë me informacion, gjithmonë përforcojmë vendosmërinë e tyre lidhur me ndërtimin e biznesit të FLP, dhe angazhimin e tyre ndaj saj që gjithmonë të përdorin nga këto produkte. Vlerësojmë mundin dhe rezultatet e tyre, dhe vendimin e tyre që kanë zgjedhur të punojnë me skuadrën tonë. U japim kurajo për të arritur në nivele më të larta dhe i ndihmojmë ata për arritjen e niveleve që synojnë.

Të kemi parasysh thënien: „të ecim me ta për atje ku duan, të rrimë me ta ku e ndiejnë veten mirë dhe të rriten atje ku zhvillohen” dhe të punojmë për të ruajtur një pjesë të madhe të distributorëve tanë duke përmirësuar aftësitë tona komunikuese.



# LONDRA NË THËRRET

Fito 800 Euro, që të udhëtosh në Global Rally në Londër!

STIMULI EUROPIAN  
1 SHTATOR-31 DHJETOR  
2013 DECEMBER 31.

## NIVELI I-RË



Grumbullo 15 cc të reja (pikët personale nuk llogariten)

+ 2 bileta hyrje për në Global Rally O2 Show


## NIVELI II-RË

Grumbullo 30 cc të reja (pikët personale nuk llogariten)

€4



+ 2 bileta hyrje për në Global Rally O2 Show




## NIVELI III-RË

Grumbullo 60 cc të reja (pikët personale nuk llogariten)

€8



+ 2 bileta hyrje për në Global Rally O2 Show



## DATA E FOREVER GLOBAL RALLY O2 SHOW: 2&3 MAJ 2014

### Kërkesat bazë për çdo nivel kualifikimi:

Çdo distributori i duhet të arrijë sasinë minimale të pikëve të skicuara më sipër. Të jetë "Aktiv" në çdo muaj të periudhës të kualifikimit. Shpallja fillon më 1 Shtator 2013 dhe përfundon më 31 Dhjetor 2013. Të gjitha kushtet duhet të plotësohen gjatë periudhës të kualifikimit. Edhe Distributorët e Rinj mund të kualifikohen, por që nga muaji i parë duhet të jenë aktiv dhe të mbeten aktiv deri në muajin e fundit të periudhës. Në muajin e fundit të periudhës të kualifikimit çdo distributor duhet të jetë aktiv. Afat i kohës të regjistrimit të distributorit konsiderohet ajo kohë kur të dhënat e Formularit të Aplikimit regjistrohen në sistemin informatik të firmës mëmë. Kjo shpallje ka të bëjë vetëm me distributorët e Foreveit të rajonit të Europës. Çdo grup i linjës së poshtme duhet të regjistrohet në vendin përkatës të banimit. Çdo shpenzim (përfshi udhëtimin, fjetjen dhe ushqimin) është përgjegjësi e Të kualifikuarit në vartësi të pjesëmarrjes në Global Rally. Është përgjegjësi e çdo distributori se si i kupton kushtet e sipërpërmendura. Programi stimulues përmban vetëm kushtet e lartpërmendura. Të kualifikuarit vetëm kundrejt pareve Cash dhe biletës së hyrjes futen përkatsisht sipas nivelit të kualifikimit. Shpërblimet nuk mund të kombinohen. Të kualifikuarit duhet të konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre deri në 15 Shkurt 2014. Çmimi Cash duhet likuiduar deri në 15 Mars 2014 sipas monedhës vendase. Ju lutemi për çdo pyetje ti drejtoheni Drejtorit Rajonal! Përrjashtime nuk është e mundur të bëhen në asnjë rast. Shpërblimi i kualifikimit nuk mund të atashohet tjetër personi.



**NËSE DO TË DËGJOSH KËTO  
TEMA... NDËRTIM SKUADRE,  
PLANIFIKIM, PËRQËNDRIM  
REZULTATI, MIDIS LEKTORËVE  
SHIKOJMË SHPESH EMRIN  
E ANIKÓ KARDOS. NDËRSA  
SHUMICA ATËHERE E FIKSOI ATË,  
KUR NË 2012 U BË NJË NGA TRE  
SENIOR EAGLE MENAXHERËT E  
VENDIT.**

## NË BIZNES KA SHUMË MË TEPËR PERSPEKTIVA

*se sa mendon*

**Sponsor:** Edit Móricz

**Linja e sipërme:** Ildikó Csepi dhe Gábor Kovács, Tibor Lőv, Vilmos Halomhegyi, László Horváth, Miklós Berkics

### Shumë pyesin, se cili është sekretit yt?

Ka ndodhur. Por nuk ka sekrete, ky është një biznes i thjeshtë. Vetëm duhet mësuar që të bëhet mirë. Duhet përvetësuar ato gjëra, të cilat themeluesi i kompanisë Rex Maughan thotë për tridhjet e pesë vjet, dhe sipas tyre të ecet përpara. Sigurisht mund të ndihmojë, nëse personi është i vendosur, punëtor dhe i përkushtuar, dhe nuk do ishte keq, nëse është tip luftarak.

### Ndoshta secili i krijon një çikë bazat sipas imazhit të tij, apo jo?

Në një farë mënyre po: biznesi i secilit ka po atë pamje, siç është ai vetë. Baza e karakterit tonë na shoqëron, dhe kjo përcakton atë, që për cilët do të kemi influencë. Në grupin tim kryesisht janë mjekë, sipërmarrës dhe persona që kanë një të kaluar sportive; kjo përmbajtje pasqyron fushat përcaktuese të jetës time.

### Atëhere të shkojmë deri në fund nëpër ato!

U rrita në bodrum. Mamaja e shoqes time punonte në spitalin e zonës, kështu që kemi luajtur shumë në oborrin e spitalit. Mua më pëlqente, që mjekët ndihmonin shumë njerëz, që mbanin përparësi të bardha... Pastaj u bëra sipërmarrëse - duke filluar që nga mosha njëzet vjeçare. Gjatë jetës time vetëm dy herë kam qenë e punësuar: një herë në një firmë shtetërore si administratore, më vonë si asistente e një sipërmarrësi. Menjëherë vendosa, që do të jem zonjë e vetes, dhe edhe unë do të jem sipërmarrëse. Fillova të merrem me rroba të modës për gra, hapa tre dyqane të pakicës në Székesfehervár dhe Pest, më pas u futa edhe në prodhim. Por nuk mund të them atë, që kjo ishte ëndrra ime, vetëm pashë, që me atë mund të fitohej mirë.

### Fusha e mjeksisë nuk të tërhoqi?

Pothuaj isha tridhjet vjeç, kur u mendova, që më vjen keq, që nuk zgjodha atë, por e përditëshmja nuk më tërhoqi, më pëlqente vetëm ideologjia e saj.





### **Tani prapë ju afrove pak tek ruajtja e shëndetit.**

Asnjëherë nuk e kisha menduar, që do të ndodhte kështu, çfardo desha të isha vetëm jo ndërtuese rrjeti. Për ata kisha një ide, gjithmonë më vinte ndër mend drama e Arthur Millerit, Vdekja e agentit. Që ndërtuesi i rrjetit është një lloj shitësi ambulant: e nxjerin nga dera, dhe ngjitet prapë nga dritarja. Nëse do suksese, atëhere duhet të jesh i pafytyrë dhe agresiv.

### **Që nga ajo kohë çfarë mendon? Ashtu duhet të ishe?**

Nuk më është dashur kurrë të përdor këto mjete për atë, që të kem grupin tim, përndryshe tashmë do ta kisha lënë.

### **Apo ata që thërrite, erdhën menjëherë?**

Jo, por kush erdhi, nuk e bëri se e sforcova. Shumë shpejt e kuptova atë, që nëse dikush nuk do asgjë, atëhere ai është problemi i tij, dhe jo i imi. Dhuna nuk funksionon as në edukimin e fëmijëve dhe as në marrëdhëniet në çift. Përse duhet të funksionojë në biznes?

### **Në vend të saj çfarë funksionon tek ti?**

Jap informacione korrekte si për produktet dhe për marketingun. E bëj me shpirt e me zemër, dhe nuk them më shumë se realiteti. Nuk ka asnjë kuptim, sepse këtu çdo gjë merret vesh shumë shpejt. Sukseset afatshkurtra nuk më interesojnë, sepse nga ato kam patur, edhe kam jetuar mirë prej tyre. Vizioni im është të ndërtoj lidhje afatgjate me një skuadër gjigande.

### **Kujtore të kaluarën sportive. Kjo për çfarë të ndihmon?**

Kam bërë atletikë, kam luajtur volejball, tenis tavoline, basketboll, kam qenë edhe kampione për qarkun. Vetëm që pastaj u martova, linda dy fëmijë, dhe mu desh ta linja, por që nga moshja tridhjet vjeçare përsëri bëj sport aktiv: jam hobbimaratoniste dhe frekuentoj palestrën. Prej këtej është tek unë vendosmëria, lufta, aftësia e dëshirës për fitore, dhe përpikmëria. Çdo gjëje jo vetëm këtu, por në të gjitha fushat e jetës i marr përfitimin: jam shumë më e ashpër se mesatarja.

### **Dhe nga e kaluara si sipërmarrëse çfarë përfiton?**

Atje mësova marrjen përsipër të përgjegjësisë. Atë, që duhet të pranoj pasojat e vendimeve të mia. Kam punuar me shumë punonjës, kisha përgjegjësi ndaj tyre, si edhe ndaj blerësve. Për moshën dyzet vjeçare krijova shumë gjëra, që shumë të tjerë nuk i kanë bërë për tërë jetën: shtëpi, udhëtime, makinë, dy fëmijë, shëndet, suksese.

### **Atëhere çfarë të motivoi aq shumë, që edhe qëndresa jote e fortë u thye përballë ndërtimit të rrjetit?**

Nuk desha të pranoja, që kjo është jeta: punojmë, ndonjëherë ikim me pushime, pastaj përsëri fillojmë nga e para. Të qenit sipërmarrës do të thotë okupim më i madh, se i një punëtori, një sipërmarrës e mundon veten, dhe unë u lodha me këtë. U mendova, kush jam, për çfarë jam këtu.... Erdhi mundësia, dhe mendova, ndoshta ky është mjete, për të cilin mund ta ndërroj sipërmarrjen time tradicionale. Për këtë shpesh herë fola me sponsorin tim Edit Mórica psikologe pa asnjë përpjekje bindjeje. Më pëlqeu lloji i të ardhurave nga e drejta e autorit, dhe ajo, që mund të jem e lirë - kjo gjithmonë ka qenë e rëndësishme. Nuk e dinja, si do jetë, apo çfarë duhet të bëjë, vetëm në një Ditë Suksesi më kapi ajo, që pashë, se si e jetojnë jetën të tjerët.

### **Dhe ashtu është nga brenda, siç e imagjinove?**

Jo tamam ashtu, shumë më tepër edhe nga ajo. Nëse vetëm aq do të realizohej, sa e ndjeva atëhere, edhe me atë mund të kënaqeshim, por në këtë biznes ka perspektiva shumë më të mëdha, se sa do të mendonim në fillim. Sa më lart shkon dikush në nivel, aq më mirë shikon, cili është kuptimi i vërtetë, dhe kjo e frymëzon më mirë.

### **Nëpërmjet kujt stacioneve përparove?**

E vërteta është, që me vështirësi u bëra supervizore - mu desh gjashtë muaj. Një herë u përballa me atë, që po qendroj në një vend, dhe nga andej realizoja prej inatit. Një vit isha supervizor, dhe të gjithë do ti këshilloja, të mos mërzhiten, sepse kjo është një periudhë mësimi: duhet me u shndruar në drejtues dhe lojtar grupi, duhet me mësuar një zanat. Në nëntor të 2010-ës tashmë isha menaxhere, në gusht të 2012-ës senior, dhe në po atë vit



eagle senior menaxhere. Pra pas nivelit të supervizorit gjërat u përshpejtuan, por pas çdo niveli duhen mësuar karakteristikat e tij; vetëm atëhere mund të ecet më tej, nëse ia kemi dalë kësaj.

#### **A ka diçka, të cilën sot do ta bëje ndryshe?**

Do ta dëgjoja sponsorin që nga momenti i parë. Si sipërmarrëse me përvojë në fillim isha kokëforte. Pa këtë historia do të ishte më e shpejtë.

#### **Mbi një bazë tjetër llogjike funksionon ndërtimi i rrjetit, nga ai i sipërmarrjes tradicionale?**

MLM-ja nuk funksionon fare mbi bazë llogjike. Më shumë e vënë në lëvizje ndjenjat, energjitë, në të vërtetë nuk ka agjë të përbashkët me ndërmarrjen tradicionale. Sigurisht ka një lloj racionalizimi, por ky nuk është ai lloj biznesi, ku çdo gjë planifikohet dhe ashtu do të bëhet: mund të ndodhin takime plotësisht të papritura, dhe me dikë mund të lëvizësh gjithë botën.

#### **Për çfarë je më krenare?**

Për dy frontmenaxherët e mi, për Dr. László Szénai me bashkëshorten Gabriella Kovács Dr. Szénainé, për Ildikó Jónás Zsoltné, dhe për menaxherin në thellësi Tibor Horváth me bashkëshorten Dr. Ilona Gróf - të gjithë janë aktivë. Është kënaqësi të shohësh, që arrijnë suksese ata, që unë i mësova për biznesin. Tani kam një objektiv të madh, që të gjithë menaxherët e mi të udhëtojnë si eagle për Lake Tahoe, dhe që deri në go diamond-in tjetër të ngrihem në nivel. Besoj, që jam motivuese e madhe. Herën e fundit i entuziazmova njerëzit për Londrën - unë me siguri do të jem atje!

#### **N.q.s. nuk merresh me Foreverin, atëhere me çfarë e kalon kohën?**

Me mësim të anglishtes, me sport, me qenin, me lexime, shëtitje dhe udhëtime - sigurisht edhe një pjesë e këtyre është e varur me Foreverin. Kam dy djem të rritur, Tibor është njëzet e katër vjeç, politolog, Krisztián është njëzet vjeç, tani do mbaroi maturën dhe po përgatitet për fushën e drejtësisë.

#### **Vjet morre një vendim të rëndësishëm: shite sipërmarrjen e vjetër. A ishte moment i vështirë?**

Gjithmonë është e vështirë të lësh një gjë, që funksionon.

Por desha të hyja në një fushë më serioze, dhe për këtë duhet të rregulloja fokusin. E shita sipërmarrjen time, dhe mbas dy muajve u bëra senior menaxhere.

#### **Si i gjen bashkpuntorët potencialë?**

Nuk kam arritur akoma në fund të listës time emërore...



# lifestyle

## Këshilla për mënyrën e jetesës

NË FILLIM TË SHEKULLIT XXI, DIABETI MBETET NJË NGA PROBLEMET MË TË RËNDËSISHME SHËNDETSORE. KJO SËMUNDJE E VENDEVE TË ZHVILLUARA NË VITIN 2011 NË BOTË KISHTE PREKUR 346 MILION VETË, DHE ME KËTË TREND SIPAS SPECIALISTËVE NË VITET 2030 NUMUERI I TË SËMURËVE DIABETIKË DO TË DYFISHOHET.

## Diabeti tek fëmijët dhe të rriturit

**N**ë Hungari numri i diabetikëve të njohur llogaritet në 600 mijë vetë. Po kështu ka një numër që nuk pacientësh që nuk njihen si diabetike por me probleme të metabolizmit të karbohidrateve që paraprijnë diabetin. Kjo do të thotë që 20% e popullsisë hungareze si individë apo 80% si familje janë të prekur nga kjo sëmundje.

Diabeti është një problem kompleks i metabolizmit, i cili në formë të pakuruar kalon në nivel të lartë të sheqerit në gjak. Pra ai është një sekrecion i pamjaftueshëm i insulinës ose/ dhe ka efekt insulinë jo në masën e duhur. Si rezultat i kësaj në organizëm krijohet një mungesë absolute apo relative e insulinës, për rrjedhim me vlera të larta të sheqerit në gjak, i cili përkeqson cilësinë e jetës dhe shoqërohet me komplikacione të vogla apo edhe të mëdha që shkurtojnë jetëgjatësinë. Rreth 10% e atyre që jetojnë me diabetin, e përbëjnë ata me **diabetin e tipit të 1-rë**, ose me të ashtuquajturin diabet të fëmijërisë. Këtë përgjithësisht e shkakton procesi autoimun, i cili sulmon dhe asgjëson qelizat prodhuese të insulinës, prandaj këtu, duke filluar nga konstatimi i tij duhet kompensuar insulinën. Si paraqitje e simptomave klasike duhet parë kur fëmija pi ujë shumë, kur urinin shpesh, i rritet oreksi

e megjithatë bie në peshë. Nga 1989 deri në vitin 2009 në Hungari, në grupmoshën 0-14 vjeç, vazhdimisht është rritur numri i rasteve të reja përgjatë një viti. Në vitin 1989, numri i rasteve për 100 000 vetë gjatë një viti ishte 7.7 ndërsa në vitin 2009 numri i fëmijëve të diagnostikuar me diabet ishte 18.2. Rritja e numrit ishte e njëjlojtë për të dy sekset, në mënyrë më të shprehur tek më të vegjlit, në grupmoshën 0-4 vjeç. Sipas njohurive aktuale diabeti i tipit të 1-rë nuk mund të parandalohet. Në këtë formë diabeti shumë rrallë mund të zbulohen komplikacionet. Prandaj në këtë fazë diabetiku nuk duket i sëmurë, por është në një gjendje të tillë që ka nevojë për kompensimin e insulinës për të ruajtur vlerat normale të sheqerit në gjak. Ai quhet i sëmurë kur zhvillohen komplikacionet. Rreziku i zhvillimit mund të paksohet dukshëm, në qoftë se zhvillimi i komplikacioneve paraprihet nga ushqyerja e duhur, nga mënyra e jetës dhe nga kompensimi i insulinës.

Në rreth 90 % të rasteve që përbëjnë **diabetin e tipit të 2-të**, shkak kryesor i tij tek të rriturit është mosndijimi i qelizave ndaj insulinës, domethënë rezistenca ndaj insulinës. Në këtë rast organizmi nuk e ndjen insulinën në kufijtë normalë dhe ka




nevojë për një sasi insuline që të kalojë pragun e lartë të sëmundjes për të patur efektin e duhur të sekrecionit. Për këtë nuk jemi mësuar të sigurojmë njohjen e sëmundjes, mbasi herëpashere jemi mësuar të masim nivelin e sheqerit në gjak dhe jo atë të insulinës. Por me prodhimin e tepërt të kësaj tashmë në organizmin e sëmurë rritet edhe mundësia e zhvillimit të sëmundjes të zemrës dhe sistemit të venave. Në qoftë se nuk e ndalojmë apo kthejmë mbrapsht këtë proces, atëhere qelizat-β që prodhojnë insulinën lodhen, dhe pastaj fillojnë të asgjësohen për shkak të prodhimit të tejzgjatur. Si rezultat i kësaj më përpara fillon të rritet niveli i sheqerit në gjak, pastaj mbrrijmë në atë pikë, kur i sëmuri mund të jetojë më tej vetëm me kompensim insuline. Edhe në këtë rast shfaqen simptomat klasike. Megjithatë në periudhën e parë simptomat janë të pakta. Prandaj në qoftë se gjatë analizave të përgjithshme nuk hidhet dritë mbi nivelin e lartë të sheqerit në gjak, shpesh për shkak të komplikacioneve kërkohet mendimi i mjekëve specialistë për kontrollin e nivelit të sheqerit në gjak. Sipas njohurive të sotme diabeti i tipit të 2-të mund të parandalohet. Megjithatë në qoftë se ka përparuar shumë, në fazën e parë për shkak të nivelit të dëmshëm të insulinës në organizëm për fat të keq shoqërohet me komplikacione. Pra komplikacionet e diabetit të tipit të 2-të mund të paraprihen vetëm në qoftë se nuk jemi diabetikë. Shkaku i zhvillimit të **komplikacioneve** që është niveli i lartë i insulinës ose edhe niveli i lartë i sheqerit në gjak sjell formimin e rritur të rradikeve të lira, sëmurjen e cipës (membranës) të qelizave dhe të faqeve të venave. Kjo në tërësi çon në dëmtimin e zemrës dhe të sistemit të venave dhe në plakjen e parakohshme të organizmit. Dëmtimi i arterieve të holla shoqërohet me dëmtime të syve dhe të veshkave si dhe komplikacione të sistemit nervor. Dëmtimi prek çdo ind të syrit, por më rëndë dëmton cipën nervore të syrit, që çon në verbim, por edhe mundësia e kataraktit të syrit është 2-5 herë më e shpeshtë. Dëmtimi i veshkave që vjen nga mos funksionimi si duhet i venave çon në insufishencën renale. Për shkak të dëmtimit të arterieve të holla që ushqejnë nervat zhvillohen shumë simptoma që dëmtojnë cilësinë e jetës si: probleme të ndjeshmërisë, dhimbje, rënie e reflekseve, ndryshime që çojnë në dobësimin e muskujve, ulje e tensionit të gjakut, probleme të ritmit të zemrës, ngërçe të stomakut, rënie në peshë, metabolizëm labilis, fshikëz e tëmthit e zmadhuar dhe me veprim të ngadaltë, probleme të shkarkimit të urinës, impotencë.

Për shkak të dëmtimit të arterieve të mëdha, bëhen më të shpeshta sëmundjet ishemike të zemrës, bajamet, dëmtim i muskujve të zemrës, inflamacione kronike, sëmundje të tensionit të lartë dhe ngushtim i koronares. Komplikacionet komplekse shpesh çojnë deri në prerjen e këmbëve të diabetikut.

Për parandalimin e zhvillimit të sëmundjes të diabetit të tipit të 2-të dhe për mbrojtjen nga komplikacionet e të dy grupeve të diabetit një rol të madh ka mënyra e jetesës. Emri greqisht i mënyrës të jetesës quhet dietë. Ato janë një tërësi rregullash që sigurojnë një mënyrë jetese të shëndetshme. Këto janë: gjumi, pirja në cilësinë dhe sasinë e duhur e lëngjeve, lëvizja dhe mënyra e të ushqyerit. Mos fjetja ndryshon funksionimin e sistemit të imunitetit.

**Fjetja** e pakët për shkak të prishjes të ekuilibrit e mban organizmin në stres. Detyra e hormoneve të stresit është të sigurojë mbijetesën e organizmit, prandaj si ndihmë të shpejtë rrit nivelin e sheqerit në gjak. Në rast stresi të vazhdueshëm (= kurrë nuk fle mjaftueshëm) energjinë e marrë me ushqimin e kthen në dhjamë. Por indi dhjamor i zorrëve në zgavrën e barkut është një organ endokrin, i ngjashëm me tiroiden. Ajo nuk është mirë as kur prodhon më pak, sin ë anorexi, apo edhe kur prodhon më tepër. Edhe në sasi më të madhe çlirohen lëndë bioaktive, që çojnë në rezistencë të insulinës, që paraprin një rëndim të gjendjes, rrit rrezikun e zhvillimit të sëmundjeve të zemrës dhe të sistemit të venave dhe ndikojnë për keq në produktivitetin. Prandaj fjetja e të rriturve me 6-8 orë, nuk është e rëndësishme vetëm për atë sepse gjatë kësaj kohë, nuk mund të hamë, por sepse organizmi ka nevojë për ruajtjen e një ekuilibri të përditshëm. Sipas orëve biologjike periudha e gjumit të thellë që pushon është nga ora 22-03. Sipas mundësive mënyrën e jetës e organizojmë në një mënyrë të tillë që të mund të flemë në këtë periudhë. Edhe këtu është i vërtetë ligji bazë që kohën e humbur nuk mund ta kompensosh. Për shkak të bioritmit të organizmit të njeriut, kohëzgjatja e barabartë por në një periudhë tjetër nuk mund të prodhojë efektin e përtëritjes të energjisë të atij që pushon.

Trupin e të porsalindurit 75-80% e përbën **uji**. Tek të rriturit 60-70% e përbën uji, ndërsa në rastin e një të rrituri me peshë 80 kg ai përbën 54 litra. Tek truri uji përbën 78%, tek gjaku 86%, tek zemra 77%, tek mëlçia 84% ndërsa tek muskujt 70%. Dhe megjithatë ne duam më shumë të hamë se sa të pimë. Por që organizmi ynë të funksionojë, ka nevojë për sasinë e duhur të ujit. Ndjenja e urisë është ngacim më i fortë se etja, dhe shumë herë hamë sepse organizmi ka nevojë për ujin e ushqimit të konsumuar.



Prandaj le të pimë lëngje në sasinë e duhur! Dhe pse? Për mbajtjen e peshës trupore optimale, për mos marrjen e kalorive, apo për marrjen e lëngjeve me kalori minimale. Në këtë kategori uji është i pazëvendësueshëm. Uji me përmbajtjen natriumi dhe lëndësh minerale të pakta ul oreksin, ndihmon djegjen e dhjamrave dhe nuk ngarkon veshkat. Natyrisht mund të pimë edhe çajin me bimë medicinale, pa kalori dhe pa embësues. I tillë është çaji me aloe, me karafil, kamomil, kanellë, anisa etj që nxit tretjen, por që është e njohur edhe për djegjen e dhjamrave. Zhumbrica në përbërjen e këtij çaji ka efekte për uljen e kolesterolit dhe të tensionit dhe pengon formimin e trombeve. Ndërsa *Gymnema sylvestre* neutralizon sasinë e tepërt të sheqerit, ushqen qelizat e pankreasit, kurse gjethet e manave të këtij çaji kanë efekt të pakësimit të sheqerit në gjak. Ky çaj i pasuruar edhe me lëkura portokalli, me karafil, me kardamon dhe pa kofeinë është një përzierje shumë e mirë për të konsumuar çdo ditë 2.5 deri 3 litra në ditë, dhe shumë mirë mund tu jepet edhe fëmijëve.

**Lëvizje!** Realisht këtu kemi lënë më shumë në baltë organizmin tonë. Ndërsa 7% e uljes të peshës trupore dhe gjimnastika me të paktën 150 minuta në javë, ul deri 58% rrezikun e zhvillimit të diabetit të tipit të 2-të. Mbajtja e peshës trupore optimale ka rëndësi si për parandalimin e diabetit të të rriturve, por edhe për parandalimin apo lehtësimin e komplikacioneve të diabetit të tipit të 1-rë apo të 2-të. Lëvizja rrit konsumin e sheqerit nga qelizat e muskujve, duke pakësuar kështu nivelin e sheqerit

në gjak. Përmirëson ndjeshmërinë e indeve ndaj insulinës, duke ulur me këtë kërkesat për insulinë, dhe rezistencën ndaj insulinës. Muskujt me masë të njëjtë edhe gjatë pushimit konsumojnë më shumë kalori, se sa indet e ngjashme dhjamore, kështu në qoftë se me lëvizje një pjesë të indeve dhjamore e transformojmë në muskuj, atëherë rritim sasinë e energjisë të shfrytëzuar për metabolizmin.

Gjimnastika duhet të jetë sistematike dhe e planifikuar. Çdo javë të paktën duhet të stërvitemi 5 herë nga 30 minuta, duke e rritur gradualisht deri në djeritje! Të rrahurat e pulsit rriten gradualisht, duke shmangur stërmundimin e organizmit! Të zgjedhim ato lloj aktiviteteve që durojnë kyçet tona, dhe atë që duam, sepse ka shumë të ngjarë që atë ta bëjmë pjesë të jetës së përditshme! Në qoftë se stërvitemi sistematikisht, vjen një moment që në fillim shumë pak njerëz e besojnë: lëvizja na mbush me gëzim. Po kështu me gjimnastikë në organizëm prodhohen më shumë endorfe ose „hormone të lumturisë”, se sa nën efektin e ngrënies të çokolatave. Për efektet biologjike të gjimnastikës mund të mësojmë shumë më tepër në shkrimin e **Ildikó Futaki** „Gjimnastika jeta jonë” në revistën FOREVER të muajit Dhjetor 2012 si dhe në shkrimin e **Dr Edit Révész** „Të jetuarit pa gjimnastikë dhe pasojat e saj”

Elementi përcaktues i mënyrës të jetesës është të ushqyerit. Si ta bëjmë këtë në rastin e sëmundjes të diabetit? Për këtë do të flasim në numerin e ardhshëm të kësaj reviste!



**Dr. Mária Hócsi**  
Mjeke specialiste pediatre,  
diabetologe, menaxhere

#### LITERATURA


1. Gyűrűs Éva dr., Chris Patterson dr., Soltész Gyula dr., Magyar Gyermekdiabétes Epidemiológiai Munkacsoport: „Folyamatos emelkedő vagy csúcsok és fennsíkok?” A gyermekkori 1-es típusú diabetes incidenciája Magyarországon (1989–2009). Orvosi Hetilap, 2011. 152. évfolyam, 42. szám 1690–1695
2. A serdülőkori BMI alakulása, valamint a diabetes és a koszorúér-betegség rizikója közötti kapcsolat. Kivonatot készítette Dr. Taybani Zoltán. 2011. május 30





### ISTVÁNNÉ KÁSA

Jo shumë kohë më parë mu kujtua, që para njëzet v jetësh e pyeta Brian Tracy-n, se si duhet të ndërtoj një biznes të suksesshëm. Ai më pyeti: Si duhet? Me mirësi, me entuziazëm! Përgjigja tjetër ishte kjo: Mënyrë e përditëshme pune! Çdo ditë, çdo ditë, çdo ditë! Ky është sekret! Atëhere këtë e shënova përgjithmonë, dhe kjo më ka ndihmuar shumë në punën time. Pra lejo, që jetën tënde ta formojnë njerëz të mëdhenjë! Për mua influencë të madhe pati Napoleon Hill: libri me titull Mendohu dhe Pasurohu. Pothuaj e përdora si Bibël. Më pas edhe librat e tjerë. Sa mirë do të ishte të takohesha edhe personalisht me të!



### NAPOLÉON HILL: 52 HAPA DREJT PASURIMIT

Bleva shumë nga ky libër, dhe ju a dhurova bashkpuntorëve të mi. „Nëse do të jesh i suksesshëm, duhet të kesh një objektiv të përcaktuar në jetë”- thekson autori. Nuk mund të jesh i suksesshëm duke ndenjtur në mëshirë të fatit. Ky libër më jepte mua udhëzime çdo javë. Çfarë duhet të bëj sot, dhe çfarë duhet të bëj në ditët e tjera të javës... Ai thotë: zjarri i motivimit duhet mbajtur gjithmonë i ndezur, orientimi shpirtëror të jetë pozitiv. Mposht frikën, që të mund të kesh objektiv! Forca e besimit: Mblidh rreth vetes ata, karakteri i të cilëve ngjan me atë të tëndin.

### LYNN GRABHORN: FUQIA E TËRHEQJES

Tek kjo punë është shumë e rëndësishme, që të mësojmë, se si të kapërcejmë qëndrimet tona të gabuara, se si të shkundesh për një nivel më të lartë, i cili sjell gjëra të mira në jetën tonë. Ndjenjat vendosin në çdo moment të jetës tonë, prandaj duhet të jemi të kujdesshëm ndaj tyre! Me ndryshimin e luhatjeve të ndjenjave dhe mendimeve mund të shndrohemi në krijues të lumturisë tonë. Do të jemi të aftë të krijojmë për veten tonë një situatë të tillë, e cila do të tërheqë vazhdimisht energji pozitive në jetën tonë. Krahas saj është shumë e rëndësishme dashuria. Ajo shëron dy njerëz: atë që e jep dhe atë që e merr.



### RALPH S. MARSTON JR: MOTIVIM ÇDO MËNGJES

Ji mirënjohës! Mirënjohja le të jetë mendimi yt i parë, dhe kështu çfardo që të fillosh, pas një farë kohe kjo do të udhëheqi bëmat e tua, dhe mund të arrish gjëra të mëdha. Në vend, që të kërkosh të këqijat, përpiqu të shohësh të bukurën në çdo gjë! Fokusohu për atë, që gjithmonë të kesh përse të jesh mirënjohës. Kur fëmijëve ju ndodh diçka e papritur e kam zakon t'ju them: numëro bekimet! Bëje zakon, që brenda teje në çdo moment të zgjohen mendime pozitive! Vlerëso atë që ke, dhe kështu më vonë, kur jeta do të bëhet më e plotë, do të jesh edhe më mirënjohës për gjithshka, që ke arritur. Bëma më e rëndësishme në jetën tënde le të jetë dashuria!

Këndi i leximit



# NJOFTIME

## NJOFTIME TË ZYRËS QËNDRORE

Me zyrat tona mund të lidheni në faqen e Internetit të distributorit në adresën [www.foreverliving.com](http://www.foreverliving.com) duke klikuar „FORGALMAZÓI BEJELENTKEZÉS”. (Për tu futur në të duhet paswordi dhe emri i përdoruesit, të cilat mund ti siguronit duke dërguar një e-mail tek qendra e informatikës me adresë: [it@flpseeu.hu](mailto:it@flpseeu.hu). Këtu mund të gjeni informacion për gjëndjen e pikëve, për blerjen me internet dhe për llogaritjen e bonusit mujor. Këtu mund të gjenden gjithashtu materiale marketingu, revista mujore, ditari aktiviteteve, përshkrimi i programeve stimuluese, materiale që mund të shkarkohen nga interneti, materiale trainimi, katalogë, politikën e biznesit të FLP et. Kanalet tona YouTube, mund ti gjeni në adresën [www.youtube.com/user/AloePod](http://www.youtube.com/user/AloePod)



## HUNGARIA

**Drejtoria Qëndrore Budapest:** | 183 Budapest, Nefelejcs u. 9-11.  
E-mail: [flpbudapest@flpseeu.hu](mailto:flpbudapest@flpseeu.hu) Tel.: +36-1-269-5370, +36-70-436-4288, -4289,  
+36 1 297 1995 Me korespondencë me letër: 1439 Budapest, Pf.:745.  
Drejtori per gjithshëm: Dr. Sándor Milesz: +36 1 297 1995,  
mobil: +36 70 316 0002  
Drejtoreshë e Marketingut dhe e Komunikimit: Bernadett Huszti:  
ext:194, mobil: +36-70-436-4212;  
Dóra Harman: ext: 157, mobil: + 36 70 436 4197  
Zsuzsanna Petróczy: ext. 131, mobil: +36-70-436-4276  
Derjtoresha e shitjeve dhe e zhvillimit: Erzsébet Ladák:  
tel.: +36-1-269-5370/ ext. 160, mobil: +36-70-436-4230;  
Seksioni i komunikimit ndërkombtare: Aranka Szecsei: ext. 136, mobil:  
+36 70 436 4229; Ottília Csábrádi: ext. 135, mobil: +36 70 436 4227  
Seksioni i Marketingut dhe Trainimit (FLP TV):  
Sándor Berkes, ext. 133, mobil: +36 70 436 4213

**Qendra e Trainimit:** 1067 Budapest, Szondi utca 34., tel.: +36-1-332-5956,  
+36-70-436-4285, +36-1- 373-0025, fax: + 36-1-312-8455  
Prenotimi sallës/ informacioni: Bálint Rókás mobil: + 36 70 436 4280  
Hapur: H-P: 10.00-21.00

**Qendra e Trainimit SONYA** Koordinimi i kohës: Veronika Kozma - kozmetiste:  
+36 70 436 4208; Melinda Ésik - parukere : +36 70 436 4178  
Skonto shërbimi: me 10 herë 10%, me 5 herë 5%  
TRAINIM FALAS në Qendrën e Trainimit Sonya! Në rrugën Szondi të martën e  
l-rë të do muaji në orën 10, ndërsa në rrugën Nefelejcs, në qendrën Sonya, çdo të  
martë dhe të enjte Lidhuni me telefonin e Foreverit: Kata Ungár 30-331-1883.

Produktet e Forever Living Products shiten me rekomandim të Shoqatës  
Hungareze të Mjekësi Alternative.  
Produktet tona mund të blihen ose porositen personalisht në përfaqsitë tona

### POROSIA E PRODUKTEVE

#### Me telefon në telecentrën tonë:

Të hënë 8-20, të martën deri të premten 10-20:  
Tel.: +36-1-297-5538, +36-1-297-5539, mobil: +36-70-436-4290, +36-70-436-4291

Të hënë 12-20, të martën deri të premten 10-18 :  
Cel: +36-70-436-4294, +36-70-436-4295

të hënë deri të premten 12-16:  
Pa pagesë mund të kërkoni në linjën: +36-80-204-983  
Adresa e-mail e telecentr: [telecenter@flpseeu.hu](mailto:telecenter@flpseeu.hu)

#### Shitje me Internet

[www.foreverliving.com](http://www.foreverliving.com) ose [www.flpshop.hu](http://www.flpshop.hu)  
Për të kontaktuar me shërbimin e klientit në Internet:  
tel: +36-22-333-167, +36-22-500-020, +36-70-436-4286,  
e-mail: [webshop@flpseeu.hu](mailto:webshop@flpseeu.hu)

Përgjegjëse e shërbimit ndaj klientit në telecentër dhe internet:  
Melinda Malik Melinda, Cel: +36-70-436-4240

produktet e porositura me telecentr ose internet ju vijnë me korier brënda  
2 ditësh, duke ua sjellë në shtëpi. Për blerjet 1 CC e lartë shpenzimet e  
transportit i mbulon firma.

**RISHITJA E PRODUKTEVE DHE REKLAMA** Produktet dhe materialet  
tona të marketingut është e ndaluar të rishiten në internet. Ato mund të  
eksponohen dhe shiten në dyqane dhe zyra në bazë të pikave 16.02 (h),  
(i), (j) dhe (k) të politikës së FLP. Rregullat që kanë të bëjnë reklamën dhe  
përgatitjen e faqes personale të internetit që lidhen me veprimtarinë e  
distributorit mund ti gjeni në pikat 16.02. (h), si dhe 17.10 të Politikës të FLP.  
Për të DHËNAT E XHIROS mund të interesohi si më poshtë:

– në internet: në pjesën e distributorit të faqes: [www.foreverliving.com](http://www.foreverliving.com),  
– në softverin Forever Telefon, – me shërbimin internet MyFLPBiz,  
– dhe qendrat tona: për partnerët e Hungarisë në numerat telefonik: +36-1-  
269-5370 dhe +36-1-269- 5371 ndërsa për vendet e tjera të rajonit tonë në:  
+36-1-332-5541. +36-1-269-5370 dhe +36-1-269-5371, kurse nga shtetet e tjera  
të rajonit në numrin +36-1-332-5541.

**Drejtoria Operative:** | 183 Budapest, Nefelejcs u 9-11. Tel.: +36-1-269-5370,  
+36-70-436-4288, -4289

Derjtori i Përgjithshëm i Menaxhimit: Péter Lenkey: cel: +36-70-436-4292  
Asistente: Mónika Vékás-Kovács: ext. 192, cel: +36 70 436 4281  
Derjtoresha e Financës: Gabriella Rókasné Véber: tel.: +36-1-269-5370/ ext. 171,  
Cel: +36-70-436-4220  
Shefe e financës: Katalin Blahut Botosné: ext. 121, Cel: +36 70 436 4218  
Derjtori i Kontrollit: Zsolt Suplicz: tel.: +36-1-269-5370/ ext. 181,  
Cel: +36-70-436 4194,  
Orari i hapjes dhe shërbimit ndaj klientit në magazinat e Rrugës Nefelejcs:  
H: 8-20, M-E: 10-20, P: 10-18,  
Në ditët e punës të çdo fund muaji 8-20,  
Përgjegjëse e shërbimit ndaj klientit: Melinda Malik Cel: +36-70-436-4240

**Derjtorja e Rajonit të Debrecenit:** 4025 Debrecen, Erzsébet u. 48.  
Tel.: +36-52-349-657, fax: +36-52-349-187 Hapur: Hënë: ora 12-20,  
të martë-premte: 10-18 (mbyllja e faturimeve 30 minuta para mbarimit të punës)  
Derjtori Rajonal: Kálmán Pósa: Cel: +36-70-436-4265

**Derjtorja Rajonale e Szegedit:** 6721 Szeged, Tisza Lajos krt. 25.,  
Tel.: +36-62-425-505, fax: +36-62-425-342 Hapur: H: 12-20, M – P: 10-18  
(mbyllja e faturimeve 30 minuta para mbarimit të punës)  
Derjtori Rajonal: Tibor: Radóczy

**Derjtorja Rajonale e Székesfehérvári:** 8000 Székesfehérvár, Várkörút  
17. Tel.: +36-22-333-167, +36-70-436-4286, +36-22-500-020. Fax: +36-22-  
503-913 Hapur: H: 12-20, M– P: 10-18 (mbyllja e faturimeve 30 minuta para  
mbarimit të punës) Derjtor Rajonal: Tibor Kiss.

Hapja për raste të veçanta: Shitja dhe porosia e produkteve në përfaqsitë dhe  
telecentrën e Hungarisë mund të bëhet edhe të Shtunën e fundit të muajit  
kur pas saj nuk ka më ditë pune nga ora 12 deri 20. Në këto raste orari i saktë  
shpallet edhe në faqet e internetit dhe në përfaqsitë tona.

**Forever Resorts** Teleki-Degenfeld Kastélyszálló, Szirák, 3044 Szirák, Petőfi u.  
26., tel.: +36-32-485-300, fax: +36-32-485-285 [www.kastelyszirak.hu](http://www.kastelyszirak.hu)  
Restoranti Sasfészek, tel.: +36-1-291-5474, [www.sasfeszketterem.hu](http://www.sasfeszketterem.hu).  
Derjtoresha e Resortave të Foreverit në Hungari Katalin Király.  
Zyra Phónix për prenotim bileta avioni Szondi u.: H-P: 12.00-18.00, Gabriella  
Pittmann +36 70436 4297

**Mjekët tanë specialistë:** Dr Edit Révész Siklósné, kryetare e Mjekëve  
Specialistë të Forever Hungari, Dr. Gabriella Kassai: 70/414-2335; Dr: László  
Mezősi: 70/779- 1943; Dr. Endre Németh: 70/389-1746; Dr. Terézia Samu:  
70/627-5678, Mjek specialist i pavarur: Dr. György Bakanek: 70/414-2913  
Mund të thirrren gjatë orarit të punës.

**KALENDARI AKTIVITETEVE:** Budapest, Success Day: 16 nëntor

### PROGRAMI TRAINIMIT VJETOR 2013

**DITË SUKSESI:** 16 nëntor;

**TRAINIME 2 DITOR:** 8-9 qershor, 12-13 tetor

### PROGRAMET STIMULUESE

15-22 shtator trainimi Go Diamond, 4-5 tetor Holiday Rally

# NJOFTIME



## SERBIA

**Zyra e Beogradit:** 11010 Beograd, Kumodraška 162.  
tel.: +381 11 397 0127, Fax: +381 11 397 0126,  
e-mail: office@flp.co.rs  
Dërgimi porosive: narucivanje@flp.co.rs  
Hapur: e hënë, e martë, e enjte: 12.00–19.30,  
Të mërkurë dhe të premte 09.00–16.30,  
Çdo të shtunë të fundit të muajit dhe në ditët e Suksesit  
9.00–12.30 Telecenter: +381 (0) 11 309 6382  
Salloni i Bukurisë Sonya: 063/394 171

**Zyra e Nishit:** 18000 Niš, Učitelj Tasina 1/3, Tel: +381 (0) 18  
514 131; Fax: +381 18 514 130, e-mail: officenis@flp.co.rs  
Hapur: e hënë, e martë, e enjte: 11.00–19.00  
Të mërkurë dhe të premte 09.00–17.00,  
Çdo të shtunë të fundit të muajit dhe në ditët e Suksesit  
9.00–12.30

**Zyra Horgosi:** Tel/fax: +381 (0) 24 792 195,  
e-mail: tinde.szolnoki@flp.co.rs  
Hapur: nga e hëna deri të premten: 8.00–16.00.  
Çdo të shtunë të fundit të muajit: 9.00–12.30.

Drejtor rajonal: Branislav Rajić  
Mjekët Specialistë: Dr. Biserka Lazarević  
dhe Dr. Predrag Lazarević: +381 23 543 318

Success Day: 27 janar, 24 mars, 19 maj, 23 qershor  
29 shtator, 24 nëntor



## MALI I ZI

**Zyra e Podgoricës:** 81000 Podgorica,  
Serdara Jola Piletića 20.,  
tel: +382 20 245 402 fax: +382 20 245 412  
Hapur: të hënë: 12.00–20.00  
Ditët e tjera të punës: 9.00–17.00  
Çdo të shtunë të fundit të muajit, hapur nga 9.00–14.00

Drejtori Rajonal: Aleksandar Dakić  
Mjeku specialist: Dr. Laban Nevenka: +382 69 327 127  
flppodgorica@t-com.me



## SLLOVENIA

**Zyra e Lubljanës:** 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 3.  
tel.: +386 1 562 3640, fax: +386 1 562 3645  
Porosi e produkteve: Cel: +386 40 559 631,  
tel: +386 1 563 7501  
Porosi me e-mail : narocanje@forever.si  
Informacione me e-mail : info@forever.si  
Hapur: hënë 12.00–20.00, të martën deri të premten  
9.00–17.00

**Zyra e Lendvai:** 9220 Lendava, Kolodvorska 14.  
tel.: +386 2 575 12 70, fax: +386 2 575 12 71  
Hapur: të hënë deri të premten 9.00–17.00  
e-mail: lendva@forever.si  
Drejtori Rajonal: Andrej Kepe  
mjeku specialist: Dr. Miran Arbeiter: +386 41 420 788  
Success Day: 23 mars, 18 maj, 28 shtator, 23 nëntor  
Trainime: Leksione të hapura çdo të mërkurë: nga ora 19.00,  
Draš Center, Maribor, Pohorska 57.



## KROACI

**Zyra e Zagrebit:** 10000 Zagreb, Trakošćanska 16.  
tel: +385 1 3909 770; 3909773 dhe 3909775, Fax: +385 1 3909 776  
Hapja gjatë verës (nga 1.7.2013 deri 2.9.2013  
të hënë dhe të enjte: 12.00–20.00,  
të martë, mërkurë dhe premte 09.00–17.00

**Zyra e Rjekës:** 51000 Rijeka, Strossmayerova 3/A  
tel: +385 51 372 361,  
Hapur: të hënë dhe të enjte : 12.00–20.00,  
të martë, të mërkurë dhe të premte 09.00–17.00  
Drejtori Rajonal : Dr. László Molnár  
Mjekët specialistë: Dr. Ljuba Rauški Naglič: mobil: +385 91 51 76 510  
në ditët teke: 16.00–20.00, Dr. Draško Tomljanović:  
mobil: +385 91 41 96 101 të martën 14.00–17.00 dhe të premte  
14.00–16.00

Trainime: Zagreb, dhe Rijeka, të hënë dhe të enjte nga ora 18.00  
Adresa e Internetit: www.foreverliving.com – përgjigja në gjuhën kroate,  
në këtë faqe mund të shiten edhe produktet

Success Day: 23 mars Zagre, 18 maj Opatij, 19 tetor Opatij– Hotel Adriatik



## SHQIPËRIA

**Zyra e Tiranës:** Tiranë, Fuat Toptani 1/5.  
Tel./Fax: +355 44 500 866  
Hapur: ditët e punës 9.00–13.00 dhe 16.00–20.00  
Drejtor Rajonal: Attila Borbáth  
cel: +355 69 40 66 810, +36 70 436 4293  
Shef Zyre: Xhelo Kiçaj: Cel: +355 69 40 66 811,  
e-mail: flpalbania@abcom.al



## KOSOVA

**Zyra e Prishtinës:** Prishtinë Rr. Azem Hajdari br. 32.  
tel.: +377 44 50 3911  
hapur gjatë ditëve të punës: 10.00–16.00.  
Derjtor rajonal: Attila Borbáth  
Cel: + + 355 69 40 66 810

flpkosova@kujtesa.com



## BOSNJE-HERCEGOVINA

**Zyra e Bijeljinas:** 76300 Bijeljina, Trg D. Mihajlovića 3.  
tel.: +387 55 211 784, +387 55 212 605, fax: +387 55 221 780  
Hapur gjatë ditëve të punës 9.00–17.00  
Derjtor rajonal: Dr. Slavko Paleksić

**Zyra e Sarajevos:** 71000 Sarajevo, Džemala Bijedića 166 A.  
tel.: +387 33 760 650, +387 33 470 682, fax: +387 33 760 651  
Hapur: të hënë, enjte dhe të premten 09.00–16.30,  
të martën dhe të mërkurën: 12.00–20.00  
Shef Zyre : Enra Ćurovac-Hadžović  
forever.flpbos@gmail.com,

Success Day: 1 qershor Sarajev, 7 dhjetor Bijeljin

# FOREVER





# DUHET GUXIM PËR TË MARRË VENDIMIN

Çifti që jeton në Túrkevén kur u martua pati secili nga dy fëmijë, fëmijë i përbashkët është Luca tetë vjeç.

Csilla është police me gradë koloneli në pension, László është masazhist. Sponsor: László Ferencz dhe dr. Virág Kézsmárki. Linja e sipërme: Ibolya Ferenc Lászlóné, dr. Nikolett Dósa, dr. Ilona Juronics dhe Géza Varga, dr. Terézia Samu dhe András Bruckner

## LÁSZLÓ HARTVIG DHE CSILLA KÁRPÁTI HARTVIGNÉ MENAXHERË

### **Kur u takuat për herë të parë me mundësin-Forever, menjëherë thatë po për ndërtimin e rrjetit?**

**Csilla:** Në 2011-ën nuk menduam në ndërtim rrjeti. Në fillim dhanë provë produktet, pastaj pamë, që para nesh ecin njerëz të tillë, të cilët besuan, që kemi të ardhme, dhe filluam edhe biznesin.

**László:** Lackó Ferenczin e njoha në 2011-shin, shumë herë më kishte thënë, që ja vlen të merresh me Foreverin. Gjithmonë e pata refuzuar me edukatë, pastaj kur Csilla pati nevojë për ndihmë, atëhere e ndjeva, që së bashku me të do ta gjejmë zgjidhjen e problemit si dhe zërin e përbashkët me njëri-tjetrin.

### **Çfarë ndryshime kanë ndodhur me ty në dy vitet e fundit?**

**Csilla:** Brenda meje në fillim pati edhe skepticizëm. Nuk kuptoja në të vërtetë, që nëpër takime cilët dhe përse marrin festime kaq të mëdha, por tashmë e di, që çfarë punë e sforcuar dhe këmbëngulëse duhet, që dikush të arrijë çdo lloj klasifikimi. Këta njerëz i shikoj me një respekt të jashtzakonshëm, qofshin vetëm dy pikësja, shtatëdhjet e pesë pikësja apo sundimtarë. Është e rëndësishme - dhe shpresoj edhe përpara të tjerëve - që kam kaluar në ndryshime pozitive të personalitetit. Në polici kam punuar në vend drejtues, jam marrë me shumë njerëz, por përvojat e marrëdhënieve hierarkike që kalova atje për njëzet e tetë vjet lanë gjurmë të thella tek unë. Këtë e bëri njerzillëku, dashuria, zemërgjerësia e marrë në dy vitet e fundit në Forever. E them me krenari, që jam e angazhuar si bashkëpunatore në Forever LivingProducts.

### **Çfarë duhet, që dikush, qoftë moshatar me ty, t'ia dedikojë veten ndërtimit të biznesit?**

**Csilla:** Guxim. Në themel nuk jam njeri që është gati të hidhet në çdo gjë, por për atë, që një njeri të filloj jetë të re në moshën dyzet vjeçare - dhe këtu mendoj për martesën me Lacin, dhe për atë, që dyzet e dy vjeç të marrim përsipër edhe një fëmijë - padyshim duhet guxim. Guxim duhej edhe për atë, që të guxonim të besonim: patjetër, jemi të aftë për ta bërë këtë biznes.

Për këtë na ndihmuan shumë drejtuesit tanë të sipërm, por edhe ato që u thanë në Holiday Rally-n e parë në Poreç. M.q.s. me bashkëshortin nuk kishim të shkuar të përbashkët, na u desh që ta krijojmë atë! Në Forever punojmë bashkë, që ne dhe fëmijët tanë të kemi edhe të ardhme të sigurt. Këtu, deri tani, çdo gjë e kemi bërë bashkë dhe për njëri-tjetrin, dhe kështu do të jetë edhe më tej. Dy muajt e fundit nuk ishin pa tensionime, debate, por gjithmonë këto dinim ti mbyllnim me atë, që çdo lot dhe çdo natë pa gjumë ka kuptimin dhe vlerën e vet.

**E ndjejë mirë, që Ti për Csillën je një prapavijë e sigurt?**

**László:** Nuk e di, që a është e lehtë apo e vështirë situata ime. Jam masazhist që nga 1986, në thelb nuk jam njeri i fjalëve. Unë më mirë e ndjej veten në bashkëbisedimet personale, Csilla di të flas më me guxim përpara një publiku më të madh, sepse edhe më parë ka pasur praktikë për këtë. Mendoj që pas kaq vitesh kam ndihmuar shumë njerëz, që patën besim tek unë, prandaj jam i besueshëm për ata edhe në Forever.

**Pra në rradhë të parë bashkëpunorët erdhën nga rrethi i klientëve të Lacit?**

**László:** Jo vetëm, por ka edhe nga andej, sepse produktet speciale të rekomanduara e vërtetuan për ata, dhe e vërtetuam edhe ne. Në fillim edhe antarët skeptik të familjes u bënë të gjithë konsumatorë produktesh, bile, djali im i mesit, Csabi u klasifikua në nivelin e supervizorit.

**Cilat janë planet tuaja?**

**Csilla:** Vetëm një muaj që arritëm nivelin e menaxherit, dhe planet konkrete akoma nuk i kemi hedhur në letër, ndonëse tashmë i dimë detyrat. Kemi plane zgjerimi dhe thellimi: shumë-shumë bashkëpunorë të sigurt 4 pikësh! Sponsori ynë Lackó Ferenc, tregon rrugën për ne, ai vendosi tani si objektiv klasifikimin në nivelin Soaring dhe Eagle, shohim dhe ndjekim hapat e tij, sepse Foreveri flet për kopimin. "Që për ku të drejton rruga, nuk e dimë, por duhet me u nis, dhe duhet ecur nëpër të deri në fund." - këtu ne tani jemi nisur!



# FOREVER DESIGN

**A e dije se edhe vetura  
jote komunikon?  
Gjithnjë e më tepër  
vetura me pamje të  
veçantë propogandojnë  
Foreverin. Lidhu edhe  
TI me ne.**



Për ndihmë teknike kërko skuadrën tonë të marketingut: [literatures@flpseeu.hu](mailto:literatures@flpseeu.hu)

# SUCCESS DAY

BUDAPEST 2013.11.16.



FJALA E PËRSHËNETJES  
**DR. SÁNDOR MILESZ**  
Drejtor i përgjithshëm



DREJTUES TË PROGRAMIT  
**ANDRÁS BRUCKNER DHE  
DR. TERÉZIA SAMU**  
Soaring Menaxherë



PO VJEN DIMRI PËRSËRI  
**DR EDIT RÉVÉSZ SIKLÓSNÉ**  
anestziologe dhe mjekë e terapisë intensive  
Soaring Menaxhere

PRODUKSIONI MUZIKOR:  
**ANSAMBLI MATYÓ**



I DUA BLERËSIT E MIJ  
**DR. LÁSZLÓ JAKAB**  
Menaxher



LONDRA NA THËRRET  
**ELEONORA BARANJI DHE JOSIP BARANJI**  
Menaxherë



PËRPARA PË NË GLOBAL RALLY!  
**DR. KATALIN PIRKHOFFER DR SERESNÉ  
DHE ENDRE SERES**  
Zafir Menaxherë



VENDI YT ËSHTË KËTU  
**JÓZSEF SZABÓ**  
Zafir Menaxher

KUALIFIKIMI I SUPERVIZORËVE,  
ASISTENT MENAXHERËVE,  
KLUBIT TË CONQUISTADORËVE,  
MENAXHERËVE, DORËZIMI I  
TARGAVE FLP, KUALIFIKIMI I  
MENAXHERËVE DREJTUES

FOREVER

**Botues:** Forever Living Products Hungari Shpk. **Redaksia:** FLP Hungari Shpk. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

**Kryeredaktor:** Zsuzsanna Petroczy Redaktor: Valeria Kismarton, Kalman Posa, Sandor Rokas,

**Layout, përgatitje për shtypje:** Crossroad Consulting Shpk. **Përkthim, redaktim:** Mimoza Borbáth, Xhelo Kicaj (shqip), Babity Gorán Vladimír, Žarko Anić Antić (kroat), Babity Gorán Vladimír, Dragana Meseldžija (serb), Jolanda Novak Csaszar, Biro 2000 Ljubljana (sloven). **Shtypshkronja:** Palatia Nyomda és Kiadó Shpk.

U përgatit në 30500 kopje. Për përbajtjen e artikujve përgjegjësia është e autorëve. Çdo e drejtë mbrohet!

[www.foreverliving.com](http://www.foreverliving.com)



EAGLE  
MANAGER  
RETREAT  
LAKE TAHOE  
2014



FOREVER